



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
Drejtoria e Administratës Zgjedhore

|        |          |
|--------|----------|
| Tiranë | protodat |
| Nr     | protnumb |

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVEKENDIMIN**  
**PËR**  
**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË**  
**ANËTARËT DHE SEKRETARËT E KOMISIONEVE TË ZONA VE**  
**TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR**  
**KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME**  
**LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 05.12.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin të datës 11 maj 2025”, ka vënë në lëvizje Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve.

Referuar nenit 19, shkronja “ç”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 7, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, të ndryshuar, miratuar me vendimin e Komisionit Rregullator, nr. 5, datë 20.11.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve emëron anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve.

Referuar nenit 19, pika 1, shkronja “n”, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese nuk përcaktohet kompetenca për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve.



## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 28, pika 1, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, do të marrë vendim për ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), jo më vonë se 90 ditë para datës së zgjedhjeve.

Kandidaturat për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, paraqiten nga partitë politike sipas procedurës të përcaktuar në nenin 29, pika 1, të Kodit Zgjedhor: dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare. Anëtar i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, në gjysmën tjetër të KZAZ propozohet nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 29, pika 1, gërma b, të Kodit Zgjedhor. Sekretari i KZAZ-së propozohet nga partia politike që propozon zëvendëskryetarin e KZAZ-së.

Në bazë të nenit 29, pika 4, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, bëhet në bazë të numrit të mandateve që ka fituar partia politike në zgjedhjet pararendëse për Kuvend.

Me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021 Komisioni Rregullator ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2021, bazuar në rezultatin e numrit e mandateve në shkallë vendi, subjektet zgjedhore janë renditur si vijon:

|   |            |
|---|------------|
| 1.Partia Socialiste e Shqipërisë        | 74 mandate |
| 2.Partia Demokratike (koalicioni PD-An) | 59 mandate |
| 3.Lëvizja Socialiste për Integrim       | 4 mandate  |
| 4.Partia Socialdemokrate                | 3 mandate  |

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3557, datë 17.12.2024 i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, kërkesë për dërgim informacion lidhur me konfigurimin lidhur me shumicë-pakicë të partive parlamentare në çeljen e Kuvendit menjëherë pas zgjedhjeve të datës 25 prill 2021.

Në përgjigje të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. 4913/1prot., datë 07.01.2025, partitë të shumicës dhe pakicës parlamentare janë si vijon:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë- shumicë parlamentare përkatësisht 74 mandate;
2. Partia Demokratike e Shqipërisë/ Koalicion PD-AN-pakica parlamentare përkatësisht 50 mandate;
3. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim- pakica parlamentare, përkatësisht 4 mandate;
4. Partia Socialdemokrate – pakica parlamentare përkatësisht, 3 mandate;
5. Partia Republikane/Koalicioni PA-AN – pakica parlamentare përkatësisht, 3 mandate;

6. Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet/Koalicioni PD-AN-pakica parlamentare, përkatësisht, 2 mandate;
7. Partia Agrare Ambientaliste/Koalicioni PD-AN- pakica parlamentare përkatësisht, 1 mandate;
8. Partia Lëvizja e Legalitetit/Koalicioni PD-AN- pakica parlamentare përkatësisht, 1 mandate;
9. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar/ Koalicioni PD-AN- pakica parlamentare përkatësisht, 1 mandate;
10. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut/ Koalicioni PD-AN- pakica parlamentare përkatësisht, 1 mandate;

Me shkresen nr. 323 prot date 17.1.2023 me qëllim percaktimin e partive te shumices dhe opozites parlamentare, Komisioneri i kerkoj Kuvendit te Shqiperise qe te vendopse ne dispozicion informacioninjn mbi qendrimet e mbajtura me vote te deputeteve te Partise Sovialsdemokrate dhe partise per Drejtësi, Integrim dhe Unitet, ne votbesimin e qeverise, ligjin e buxhetit, etj gjate periudhes se legislatures te viteve 2021-2025.

Me shkresen nr. 323/1 prot date 23/01/2025, Kuvendi i Shqiperise ka percjelle ne KQZ informacionin arkivor lidhur me qendrimet e mbajtura nga deputetet e ketyre partive per “Per miratimin e programit politik dhe perberjes se keshillit te ministrave” date 16 shttaor 2021, procesverbalet per votimin ne teresi te projektligjeve per miratimin e buxhetit te shtetit per vitet 2022, 2023 dhe 2025. Nuk ka percjelle informaiconin per votimin e projektligjit per Buxhetin e vitit 2024 per shkak se votimi eshte bere me karton dhe nuk disponojne votim individual te deputeteve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur nga Kuvendi i Shqiperise reulton ky qendrim i mbajtur nga deputetet e ketyre partive politike parlamentare:

| Projektvendime të Kuvendit të Shqipërisë   | Viti              | Emër    | Mbiemër | Subjekti që përfaqëson | Vota   |
|--|-------------------|---------|---------|------------------------|--------|
| Projektvendim "Për miratimin e programit analitik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave | 16 shtator 2021   | Gledis  | Çeliku  | PSD                    | Pro    |
|  |                   | Meri    | Markiçi | PSD                    | Pro    |
|  |                   | Gerdjan | Deda    | PSD                    | Pro    |
| Për votimin e çështjeve të parashikuara në seancë plenare (1 nga pikat "Për Buxhetin 2022) | 15-16 nëntor 2021 | Gledis  | Çeliku  | PSD                    | Pro    |
|  |                   | Meri    | Markiçi | PSD                    | Pro    |
|  |                   | Nusret  | Avdulla | koalicioni PD-AN       | Kundër |
|  |                   | Shpëtim | Idrizi  | koalicioni PD-AN       | Kundër |
|  |                   | Gerdjan | Deda    | PSD                    | Pro    |
| Për votimin e çështjeve të parashikuara në seancë plenare                                  | 25 nëntor 2021    | Gledis  | Çeliku  | PSD                    | Pro    |
|  |                   | Meri    | Markiçi | PSD                    | Pro    |
|  |                   | Gerdjan | Deda    | PSD                    | Pro    |
| Për votimin e çështjeve ta   | 7                 |         |         |                        |        |

|   |                       |                |                     |              |
|---|-----------------------|----------------|---------------------|--------------|
| parashikuara në seancë plenare<br>(nuk kuptohet votimi)                               | dhjetor<br>2021       |                |                     |              |
| Për votimin e çështjeve ta<br>parashikuara në seancë plenare<br>(nuk kuptohet votimi) | 21<br>dhjetor<br>2021 |                |                     |              |
| Për buxhetin 2023   | 10<br>nëntor<br>2022  | Gledis Çeliku  | PSD                 | Pro          |
|   |                       | Meri Markiçi   | PSD                 | Pro          |
|   |                       | Gerdjan Deda   | PSD                 | Pro          |
|   |                       | Shpëtim Idrizi | koalicioni<br>PD-AN | nuk<br>votoi |
|   |                       | Nusret Avdulla | koalicioni<br>PD-AN | nuk<br>votoi |

Në analizë të dispozitave të Kodit Zgjedhor, rezultati përfundimtar i zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021, dhe të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë 4913/1prot., datë 07.01.2025 dhe 323/1 dt 23.1.2025, arsyetohet si vijon:

- Neni 29, pika 4, fjalia e dytë, i Kodit Zgjedhor, përcakton qartë procedurën që ndiqet për caktimin e partive që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve. Në zgjedhjet për Kuvend, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të mandateve të fituara në shkallë vendi për zgjedhjet pararendëse për Kuvend nga partitë parlamentare.

Që një parti të gëzojë të drejtën për të propozuar kandidatë për KZAZ, duhet të plotësojë 2 kushte, së pari të ketë marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse për Kuvend dhe së dyti, të jetë parti parlamentare.

- Dy anëtarë të KZAZ-së i propozon partia kryesore e shumicës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh mandateve në shkallë vendi për zgjedhjet për Kuvend, brenda konfigurimit të shumicës parlamentare sipas rezultatit të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021. Një anëtar të KZAZ-së e propozon partia e dytë e shumicës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh të mandateve në shkallë vendi për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, pas partisë kryesore të shumicës.

- Ne analize të shkresave dhe dokumenteve të percjella nga Kuvendi i Shqipërisë rezultojnë se Partia Socialiste e Shqipërisë është partia kryesore e shumicës parlamentare me 74 mandate;

- Partia Socialdemokrate e Shqipërisë është partia e dytë e shumicës parlamentare me 3 mandate

- Dy anëtarë të KZAZ-së i propozon partia kryesore e opozitës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh të mandateve në shkallë vendi për Kuvend, brenda konfigurimit të pakicës parlamentare, sipas rezultatit të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021. Një anëtar të KZAZ-së e propozon partia e dytë e pakicës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh të mandateve në shkallë vendi, për Kuvend, në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, pas partisë kryesore të pakicës.

- Ne analize të shkresave dhe dokumenteve të percjella nga Kuvendi i Shqipërisë rezultojnë se Partia Demokratike është partia kryesore e opozitës parlamentare me 50 mandate;

- Partia e Lirisë është partia e dytë e opozitës parlamentare me 4 mandate

- Kodi përcakton se anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare. Në zgjedhjet për Kuvend, anëtari i shtatë do të përcaktohet me short ndërmjet partisë së parë të shumicës parlamentare dhe partisë së parë të opozitës parlamentare.

Shortit ndërmjet “Partisë Socialiste të Shqipërisë” dhe “Partisë Demokratike” për përcaktimin e anëtarit të shtatë, do të përcaktohet dhe partia, e cila ka të drejtë të propozojë sekretarin e KZAZ-ve.

Shorti do të ndjekë hapat e përcaktuar në nenin 4, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, të ndryshuar.

Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, përfaqësuesi i cili tërheq goglën në enën e dytë, i lind e drejta të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve sipas përcaktimit në shiritin e letrës brenda goglës së tërhequr (tek a çift).

Në bazë të nenit 29, pika 2, të Kodit Zgjedhor, në përfundim të shortit, anëtari i shtatë i KZAZ-ve do të propozohet nga “Partia \_\_\_\_\_”.

Anëtari i shtatë do të propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga Partia Socialiste e Shqipërisë, si parti e parë e shumicës parlamentare, ndërsa në gjysmën tjetër të KZAZ-ve nga Partia Demokratike, si parti e parë e opozitës parlamentare, në përputhje me rezultatin e shortit që do të hidhet në KQZ.

Partitë politike duhet të paraqesin kandidaturat për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve brenda datës \_\_\_\_01.2025 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në përputhje me përcaktimin e nenit 28, pika 1, të Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 11 maj 2025”.

**Erion META** - Drejtorja e Administratës Zgjedhore

**Pavlina DOÇAJ** - Drejtorja e Ligjshmërisë

**Majlinda ÇELMETA** - Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

**PROJEKTVENDIM**  
**PËR**  
**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT**  
**DHE SEKRETARËT E KOMISIONEVE TË ZONA VE TË ADMINISTRIMIT**  
**ZGJEDHORË, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 29, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**VENDOS:**

- Partitë politike që do të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-ve) për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025 janë si më poshtë:
  - Partia Socialiste e Shqipërisë (PSSH), si partia kryesore e shumicës parlamentare, propozon 2 (dy) anëtarë;
  - Partia Socialdemokrate (PSD), si partia e dytë kryesore e shumicës parlamentare, propozon 1 (një) anëtar;
  - Partia Demokratike (PDSH), si partia kryesore e opozitës parlamentare, propozon 2 (dy) anëtarë;
  - Partia e Lirisë (PL), si partia e dytë kryesore e opozitës parlamentare, propozon 1 (një) anëtar.
- Bazuar në rezultatin e shortit për përcaktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë në përbërjen e KZAZ-ve:
  - Partia Socialiste e Shqipërisë (PSSH) do të propozojë anëtarin e shtatë për KZAZ-të e renditura me numër \_\_\_ (tek/çift), sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  - Partia Demokratike (PDSH) do të propozojë anëtarin e shtatë për KZAZ-të e renditura me numër \_\_\_ (tek/çift), sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendim
- Sekretari i KZAZ-së do të propozohet:
  - nga Partia Socialiste e Shqipërisë për ato KZAZ ku kjo parti propozon zëvendëskryetarin;
  - Nga Partia Demokratike për ato KZAZ ku kjo parti propozon zëvendëskryetarin.
- Partitë politike duhet të paraqesin kandidaturat për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve në KQZ nëpërmjet portalit të partive politike jo më vonë se data 01.02.2025.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: DD MM VVVV Nr: 00 00  
Ora: HH:MM



Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

